



24-12-2018

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Numri i lëndës: 2018:037933

Datë: 13.11.2018

Numri i dokumentit: 00171847

P.nr.954/2018

**NË EMER TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Shtimes, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1130-7/2018 e dt.12.07.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të akuzuarit [REDACTED] dhe të dëmtuarit [REDACTED], me datë 13.11.2018, solli dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Shtime, i lindur me datë [REDACTED], në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, punon privat i gjendjes së mesme ekonomike me nr. të letërnjoftimit [REDACTED] mbrohet në liri,

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse** – me dt. 18. Maj 2018, rreth orës 12:00, në rrugë “ Tahir Sinani “, në Shtime, duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “ VW Golf ”, me tabela të regjistrimit [REDACTED] ka rrezikuar trafikun publik duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurin e tyre, me ç’rast ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 53.1 dhe 54.1.2 (b) të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që ndërmerri një veprim pa u siguruar se mund të rrezikoj pjesëmarrësit e tjerë të komunikacionit dhe nga pakujdesia, me pjesën e parë të anës së djathtë godet në anën e majtë në rrotën e pasme biçikletën të cilën ishte duke drejtuar i dëmtuari [REDACTED] e i cili në momentin kritik ishte duke u çkyqur nga rruga kryesore për të hy në parkingun e qendrës tregtare “ Viba Fresh”, me ç’rast si pasoj e këtij aksidenti, i dëmtuari [REDACTED] pëson lëndime trupore, e që bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit

mjeko ligjor të datës 26.06.2018, lëndimet e tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me pësoja të përkohshme për shëndetin,-

*-Me të cilën ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga nen.378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.*

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe neneve 365,465 të KPPRK-së të akuzuarin e

## G J Y K O N M E D Ë N I M M E G J O B Ë

Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 100 /njëqind / Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 15, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

I dëmtuari [REDAKTUAR], nga fshat [REDAKTUAR] Komuna Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale për ekspertizën mjeko-ligjore 20,00 Euro për ekspertizën e ekspertit të komunikacionit në shumë prej 40,88 Euro si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro gjithsej në shumë prej **80,88 Euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit i shqiptohet taksa në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1130-7/2018 e dt.12.07.2018, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], Komuna e Shtimes, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me datën 13.11.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Avdullah Abedini, i akuzuari [REDAKTUAR] dhe i dëmtuari [REDAKTUAR].

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas



prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në tersi mbështet deklaratën që ka dhen në polici iku ka pranuar veprën penale që e ka kryer dhe atë ditë ishte duke e vozitur automjetin e tij prej drejtimin të komunës në drejtim të Stacionit Policor në Shtime, ku me të arritur përballë marketit " Viva ", ku i dëmtuari pasi e ka drejtuar biçikletën në anën e majtë për të hyrë në marketin "Viva ", e ka goditur të njëjtin në pjesën e parë të anës së djathtë në anën e majtë në rrotën e pasme Biçikletën, ku edhe është rrëzuar në tokë dhe është dalë dhe të njëjtin e ka dërguar në emergjencë dhe pastaj ka shkuar në polici për të dhënë deklaratë, por kjo që i ka ndodhur i ka ndodhur pa dashje, siq mund ti ndodh çdo vozitësi në komunikacion, i kërkon falje të dëmtuarit ku edhe ky ka pësuar lëndime në këtë aksident, ka kërkuar nga gjykata që gjatë shqiptimit të sanksionit penal të ketë parasysh pranimin e fajësisë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi pranimi i tillë është bërë konform ligjit gjegjësisht në bazë të nenit 248 të KPPK-së, dhe ka mbështetje edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të cilat e vërtetojnë gjendjen faktike.

I dëmtuari [REDAKTUAR], ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurit ndërsa kërkesën pasurore-juridike do ta kërkoj nga kompania e sigurimeve ku i pandehuri ka patur të siguruar veturën e tij.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vetëtuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale leximi i konstatimit të ekspertit të komunikacionit i datës 18.06.2018, konstatimin dhe mendimin ekspertit të mjekësisë ligjore të datës 22.05.2017, deklarata e të pandehurit dhe të dëmtuarit, dhënë në procedurën hetimore në polici si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës e nga të gjitha këto gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit, pendimin për veprën penale të kryer, heqjen dorë nga ndjekja penale e të dëmtuarit, gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 150 /njëqind/ Euro, si në

dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, të dëmtuarin [REDAKTUAR], nga fshat [REDAKTUAR], Komuna Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve gjyqësore në shumën dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 80,88 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,  
**P.nr.954/18 me datë 13.11.2018**

**Zyrtarja ligjore**  
Kadishe Shabani

**Gjyqtari**  
Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.